



PËRSE GJITHË KJO FRIKË NGA ISLAMI?



المهجة الإعلامية الأناضولية
مدار الإفتاء - مدينة شموخدا
KORDINIMI MYSLIMAN I SHKODËRIT
MYFTINIA SHKODËR

PËRSE GJITHË KJO FRIKË NGA ISLAMI?



المشيخة الإسلامية الألبانية

دار الإفتاء - مدينة شندرا

KOMITETI MUSLIMAN I SHQIPËRIE

MYFTINIA SHKODËR

Dr. Muhamed Said R. El-Buti
Xheudet Said

Përse gjithë kjo frikë nga Islami?

Përktheu dhe përshtati nga arabishtja:
Lavdrim Hamja

Redaktor: **Muhamed Sytari**

Lektor: **Albri Brahusa**

Boton: **Myftinia Shkodër**

ISBN 978-99943-50-74-2

Sh.B.Arbëria

Shkodër - Shtator, 2013

Dr. Muhamed Said R. El-Buti
Xheudet Said

Përse gjithë kjo frikë nga Islami?

Përktheu nga arabishtja
Lavdrim Hamja

- *Këshilla ime për perëndimorët, të cilët frikësohen sot nga Islami*
(Dr. Muhamed Said R. El-Buti)
- *Përse gjithë kjo frikë nga Islami?*
(Xheudet Said)
- *Islami mes rinovimit të kërkuar he ndryshimit të refuzuar*
(Dr. Muhamed Said R. El-Buti)

Dr.Muhamed Said Ramadan El-Buti

1 | **KËSHILLA IME
PËR PERËNDIMORËT,
TË CILËT FRIKËSOHEN
SOT NGA ISLAMI**



Që në fillim të 70-ve, Perëndimi me të dy pjesët e tij, Evropën dhe Amerikën, po jeton një periudhë frike, të cilën e quan “*ekstremizëm islam*” dhe kjo në të vërtetë nuk është frikë nga ekstremizmi i myslimanëve, por është frikë nga vetë Islami, nga përhapja e tij e madhe në të ardhmen, e parashikuar në Perëndim përgjithësisht dhe në Amerikë

veçanërisht.

Deshi Zoti që të më bie në dorë një vendim i vjetër i Perëndimit, i cili përshkruan këto frikësime. Këtë vendim e ngriti në OKB William Clifford¹ (*Drejtor i Institutit të Shkencave Kriminale në Australi*) në një prej seancave në seminarin e mbajtura nga Organizata Arabe për mbrojtjen sociale kundër krimit, me iniciativë nga Universiteti i Shteteve Arabe në mesin e viteve 70-të... Më vonë më bie në dorë një vendim tjetër, i cili përshkruante të njëjtat frikësime dhe ky ishte ai që shqyrtoi Këshilli i Sigurimit Kombëtar amerikan në fillim të viteve 70-të në qarqet speciale amerikane.

Në këto dy vendime nuk frikësohej nga ajo që e quanin ekstremizëm islam, por frikë nga vetë Islami. E vërteta është se ky realitet është një nga argumentet,

1. Mr. William Clifford - Ka qenë përfaqësues i Kombeve të Bashkuara në disa konferenca të organizatës arabe për mbrojtjen e shoqërisë kundër krimit, e dalë nga Konferenca arabe nga fundi i viteve 70-të. Clifford mori pjesë në të si vëzhgues. Pastaj dërgoi një dosje të fshehtë në Organizatën e Kombeve të Bashkuara dhe në departamentet e interesuara, duke folur për rrezikshmërinë e Islamit dhe për mundësitë e mëdha që ai të kthehet në gjendjen e tij vepruese. Deshi Zoti që kjo dosje të bie në dorën time, ku dhe kam shkruar një studim të mjaftueshëm rreth tij në librin tim: *Ala tarikil-avdeti ilel-Islam (Në rrugën e kthimit për tek Islami)*.

të cilat dëshmojnë se ekstremizmi islam, të cilin po e shohim apo dëgjojmë për të, këtu e atje, nuk ka dyshim se planet për të janë kurdisur e realizuar në qarqe speciale perëndimore, pastaj fryhen dhe inspirohen te punonjës e kriminalistë të stërvitur mirë, në vende e shtete në të cilat kryhet ky ekstremizëm i planifikuar për këto shtete.

* * *

Me të vërtetë ajo që dua të them për perëndimorët në përgjithësi, është se: *Nuk ka dyshim se Islami i vërtetë, s'është ai rreziku për Perëndimin, ose për qytetërimin perëndimor sot, por përkundrazi ai është "antibiotiku", i cili mbron qytetërimin perëndimor nga shkatërrimi dhe e shëron atë nga sëmundjet parazitare të përhapura sot dhe e rikthen atë në fillimin e fuqisë e të rinisë së saj, n.q.s Perëndimit do t'i jepej mundësia të mbështetej në të, ose ta kuptojë atë me të vërtetë.*

S'ka aspak dyshim se rreziku i vërtetë, i cili është në pritje të qytetërimit perëndimor, është fesadi (prishja, degjenerimi) dhe është

i njëjti shkak, i cili depërtoi në perandorinë romake ku pastaj e ekzekutoi atë me vdekje.

Prishja dhe degjenerimi nga i cili po vuan sot Perëndimi përmbledhet në atë që ai është shmangur plotësisht në bashkëpunimin e tij me qendër mjetet d.m.th materien, dhe ka harruar njeriun.

Me të vërtetë shkenca me të cilën po punon sot shoqëria perëndimore është shkenca për mjetin: Rëndësia e tij, mënyra e evoluimit, së bashku me një konkurrencë ngulmuese me të tjerët në këtë pistë gare.

Shoqëria perëndimore harroi se mjete është ai i cili duhet të jetë në shërbim të njeriut dhe jo e kundërta. Pastaj, kjo të detyron që shkenca në shkallë të parë të fillojë me njeriun duke e studiuar atë nga qenia e tij: *Kush është ai? Cila është zanafilla e tij? Nga anojnë dëshirat e tij? Çfarë ushqimi duhet t'i shërbehet shpirtit dhe qenies së tij? Cila është rëndësia e sjelljeve dhe cili është burimi i obligimeve dhe i detyrimeve në sjelljet e tij?...*

Me të vërtetë fatkeqësia e Perëndimit është se ai shkoi në shenjtërinë e mjetit, rrugë e cila e çoi në rënie së bashku me njeriun dhe e bëri atë jo më shumë se një

rob, i cili lëvizë me dorën e mjetit, nga ku pastaj humbi dhe refuzoi rëndësinë, madje edhe kujdesin se me çfarë duhet të ushqejë qenien dhe shpirtin e njeriut që të mbushi boshllëqet e tij. Duhej që çështja të ishte në të kundërtën... të drejtonte kujdesin më të madh te domethënia njeri dhe realiteti i tij, tek ushqimi i aspiratave e dëshirave të tij dhe që mjeti të jetë, jo më shumë se sa shërbëtor në domethënien njeri si qenie e tij njeri.

Kjo është fatkeqësia, e cila i trashëgoi njeriut të qytetërimit perëndimor boshllëkun në mendimin e tij, ku rruga është kërkimi dhe pyetja, zbrazëti në qenien e tij, ku nuk rend duke kërkuar dashuri, por akoma nuk e di se kush është e dashura e tij dhe boshllëk në kuptimin e marrëdhënieve në mes tij dhe kësaj gjithësie.

Me të vërtetë brezi, i cili mbaroi apo pothuajse mbaroi roli i tij në jetë, nuk ndjen për këtë boshllëk në atë masë që ndjenë për problemet apo natyrën e vetmisë, sepse ai është i zhytur në preokupimet e detyrave dhe në problemet shkencore e politike, shoqërore e jetësore, të cilat janë bërë rutinë e vetvetishme dhe jo më shumë, duke e

humbur kuptimin e jetës.

Por ai që në të vërtetë ndjen për këtë boshllëk frikësues, ose më saktë trishtues, është brezi i ri, i cili është akoma i brishtë në ndeshjen e tij me këtë botë dhe me njohjen për jetën. Kjo sepse ai nuk gjen se me çfarë ta zërë e ta mbushë kohën prej këtyre detyrave të ndryshme dhe sepse një pjesë e madhe prej pjesëtarëve të brezit të tij nuk gjejnë ngrohtësi e mbështetje në jetën e tyre të ndjenjave të foleja familjare, madje ata as që bëjnë pjesë në këtë fole e as që e njohim atë.

A nuk e shikoni se si largohet ndonjëri prej tyre nga rezultati i këtij boshllëku mendor e sentimental shkatërrues në drejtim të rrugëve të hutimit e të harresës të pasqyruara në llojet e ndryshme të drogës e lëndëve të tjera narkotike dhe në artin e gjetjes të të gjitha llojeve jonormale, duke filluar nga devijimi mendor deri në dëfrime të çmendura anormale, devijime seksuale, anarshi krimesh e vrasjesh pa asnjë kuptim e shkak!?!..

Ndoshta jeni në dijeni për atë që agjenci të ndryshme lajmesh kanë publikuar se 40%

e shkollave fillore në Amerikë, nxënësit e tyre i nënshtrohen marrjes së një përqindje lënde narkotike nën mbikëqyrjen e mjekëve specialistë, në mënyrë që të ruhet ekuilibri mendor tek nxënësit.

Një gjë është e sigurt, se ky brez i lindur është i papërgatitur që të mbartë përgjegjësitë e politikës, qeverisjes dhe të udhëheqjes sociale dhe marrjes në dorëzim të tyre prej brezit krijues, i cili është përgatitur të largohet.

Unë jam i bindur se kjo dukuri është shumë më e rrezikshme dhe më e përhapur në Amerikë, se sa në vendet evropiane të cilat nuk janë në të njëjtin nivel të kësaj dukurie, por hyrjet dhe shkaqet janë po ato të gjendura këtu e atje, atëherë pra patjetër do të vijnë pas tyre rezultatet, herët apo vonë.

* * *

Pra, ky është rreziku i cili kërcënon qytetërimin evropian dhe jo Islami sipas shumë raporteve për një pjesë, të të cilave ju

bëra të ditur.

Po si jo... ky është rreziku, atëherë cili është mjekimi? Mjekimi është që Perëndimi të drejtojë gjithë interesin e tij te njeriu më tepër se sa interesimi i tij për mjetet... nuk kam për qëllim interesimin për njeriun me atë që gjendet prej të drejtave të tij e prej debateve e poteres që bëhet rreth këtyre të drejtave në arenën politike të zbatimit të tyre këtu e atje, por ajo që kam për qëllim është njohja e realitetit të njeriut në qenien e tij të përgjithshme dhe njohjen e dëshirave dhe nevojave shpirtërore prej të cilave nuk ka mbetur sot asnjë arsye që të injorohen apo mohohen.

Çështja është tepër kritike për përgjigjet e shumë pyetjeve, të cilat detyrimisht lindin vetvetiu te një pjesë e madhe e pjesëtarëve të brezit të lindur në oqeanin e kësaj bote materiale mekanike shkatërruese, e cila i shton tensionet nervore e tronditjet vetjake dhe ato janë: *Kush jam unë? Përse kam ardhur? Cila është vdekja? Cili është përfundimi (destinacioni)?* Pastaj të vijë përgjigja për të gjitha këto, e disiplinuar me kritere shkencore, larg iluzioneve e supersticioneve,

të cilat kanë depërtuar sot në mentalitete të shumta perëndimore nën pretekstin e kërkimeve dhe studimeve shpirtërore, nga e cila po vuan sot një e pjesë e madhe e brezit të ri në Perëndim.

Atëherë pra, ku mundemi të gjejmë gjurmët e këtyre përgjigjeve larg nga supozimet iluzioniste e larg nga paradat mitologjike? Nuk e teproj e as që jam fanatik nëse them: *Me të vërtetë ajo që ju shpëton juve me këto përgjigje dhe ju njeh me realitetin e krejt njeriut dhe vlerëson atë si zotëriun e gjithë krijesave, padyshim ai është Islami.*

Nuk i them politikanëve të perëndimit e intelektualëve të tyre ejani përqafoji Islamin, por po i them: Ejani dhe kuptojeni Islamin, larg imazheve të mjegulluara, të cilat kanë rënë mbi të dhe larg mendimeve të futura qëllimisht. Atëherë, së pari do të familjarizoheni me të dhe së dyti do të përputhet realiteti i tij me kërkimet tuaja shkencore dhe do ta arrini të kuptoni se Islami është streha, e cila do të shpëtojë brezin e ri perëndimor nga vatra e humbjes dhe e mbytjes.

Ajo që kërkohet në këtë situatë është vetëm një gjë, që ju të largoni nga mendjet

tuaja se Islami është rrezik kërcënues dhe ta konsideroni në vend të këtij mendimi të keq, si një shok të sinqertë, si strehë e situatave të vështira dhe lënia e lirë për cilindo që dëshiron ta studiojë, ku pastaj ta përqafojë atë pa u ushtruar presion mbi të...

Ndoshta e dini se qëllimi është për Hofman², ambasadorin e Gjermanisë në disa shtete arabe, i cili u shkarkua nga detyra e tij si ambasador dhe prej shumë të drejtave të tij sociale, vetëm se ai pranoi Islamin.

Ndaj ajo që dua t'i them vëllezërve të mi të Perëndimit, sidomos politikanëve të tyre është po ajo që i kam thënë para disa viteve këshilltarit të parë të Ambasadës Amerikane në Damask, Laërence Silverman: *Sikur t'i jepej mundësia Perëndimit të drejtojë vëmendjen nga Islami i vërtetë dhe të marrë*

2. Murad Wilfried Hofmann: Ka lindur si katolik në vitin 1931 në Aschafenburg, Gjermani, por është konvertuar në Islam në vitin 1980. Ka studiuar në Universitetin Harvard. Është autor i disa librave islam, "Udhëtimi për në Mekë" dhe "Islami - Si alternativë". Shkaku i konvertimit të tij në Islam ka qenë rezultat i dëshmime të tij për luftën algjeriane për pavarësi. Ka shërbyer në diplomacinë gjermane nga 1961-1994. Shërbimin e tij të parë e ka bërë në Algjeri si specialist i Çështjeve të Mbrojtjes Nukleare. Gjithashtu ka shërbyer si Drejtor i Informacionit të NATO-s dhe Brukselit nga viti 1983-1987, ambasador në Algjeri nga 1987-1990 dhe ambasador në Marok nga viti 1990-1994. ...

mjekimin e pleqërisë së qytetërimit perëndimor, para se ta arrijë vdekja, atëherë do të rikthehet ky qytetërim në forcën e tij rinore e do të qëndrojë në krye të udhëheqjes së botës dhe kjo na gëzon edhe neve myslimanëve. Atëherë do të jemi mbështetja më e mirë e planit të globalizmit, të cilit i bie sot me dy telat e tij Perëndimi dhe Amerika.

Por në qoftë se perëndimi do të vazhdojë ta mbajë këtë barrierë artificiale mes tij dhe Islamit, do të vazhdojë i frikësuar me rrezikun e vërtetë, i cili po vërshon me shpejtësi në mesin e të gjithë shoqërisë perëndimore dhe për një pjesë të të cilit fola pak më parë... atëherë përfundimi i kësaj do të jetë shkatërrimi i qytetërimit perëndimor me të gjitha pasojat dhe efektet e tij, brenda një periudhe më e shumta një gjysmë shekulli, sipas parashikimeve të shumë sociologëve perëndimorë, ndaj dhe kush ka lexuar tregimin "Ora e 25-të" të shkrimtarit Constantin Gheorghiu³, i di fare mirë hollësitë dhe besueshmërinë e asaj që po them.

I thashë Silvermanit: - *Shpresoj të mos më*

3. Constantin Virgil Gheorghiu (15.9.1916 – 22.6.1992), shkrimtar rumun, i cili u bë i famshëm për novelen e tij, "The 25th Hour", 1949.

kuptoni politikisht, se po loz përmes fjalëve të mia me fjetet e politikës, por më kupto si mik, i cili është shumë xheloz për qytetërimin perëndimor që atë ta arrijë venitja e shuarja para se të sillet nga mjekimi i gatshëm e ekzistues.

Më tha: - E vlerësoj këshillën tuaj dhe jam dakord që ne seriozisht duhet të kërkojmë për rrugëdalje nga rreziku, të cilin e bëre të ditur.

Shpresoj që së shpejti të binden amerikanët se mjekimi i vërtetë, padyshim është Islami.

Xheudet Said

2 | PËRSE GJITHË KJO FRIKË NGA ISLAMI?



Është shumë e dobishme dhe me vlerë të dimë mendimet dhe rezultatet, të cilat i kanë arritur studimet paraprake të shumë parashikuesve perëndimorë të së ardhmes. Sepse këto rezultate, që i kanë arritur, mund të jenë të dobishme për ne, të vërteta qofshin apo jo, në rast se dimë t'i vendosim në vendin e duhur.

Nga fundi i shekullin e 19-të dhe deri tani ka pasur shumë studime dhe kërkime, forma, metoda dhe mënyra të ndryshme, të cilat i përdorin këto kërkues e studiues, del e qartë rëndësia e Islamit në kohën e sotme

dhe në të ardhmen.

Gjithë ky interesim rreth Islamit nuk mund t'i fshihet as edhe lexuesit të thjeshtë, i cili me një vështrim të lehtë do të dallojë në forma të ndryshme përzierjen e kësaj rëndësie dhe interesimi me frikë, e prej saj me xhelozë e marrëzi.

Përtë gjitha këto qëndrime dhe pikëpamje shprehet Leopold Weiss¹ (Muhammed Esed) në fjalimin e tij se: *“Shkaku i të gjithë këtyre pikëpamjeve e qëndrimeve është se ata e kanë kuptuar, qoftë edhe pa e ndjerë, se me të vërtetë mendimi islam, është mendimi i përshtatshëm dhe i qëndrueshëm, i cili mund t'i bëjë ballë mendimit kohor dhe t'i japë atij vendin që i takon pa asnjë anësi ose padrejtësi, nuk i jep me tepër sa i takon, por as që ia merr të drejtën e tij”*.

Prandaj ata shqetësohen nga ky qëndrim dhe e marrin si turp kur shohin se kush po ecën përkrah tyre në këtë drejtim dhe për këtë nxitojnë e shpejtojnë në fshehjen e

1. Leopold Weiss (Muhammed Esed) - (2.6.1900 - 23.2.1992): Gazetar, eksplorator, shkrimtar, sociolog kritik, gjuhëtar, reformator, diplomat, teoricien politik, përkthyes dhe studiues. M.Esed në shek.XX ka qenë personi më me influencë i myslimanëve evropianë.

këtyre ndjenjave.

U habita në fillim të kërkimeve të mia për këtë çështje kur vura re gjithë atë frikë dhe tmerr nga kërkimet e mia. Disa e konsideronin si një mundësi e parashikim; prej tyre:

Amerikani George Sarton², i cili në një studim të tij të titulluar: “Kujdesi i Lindjes së Mesme për kulturën perëndimore” shkruan: *“Me të vërtetë hapat e hedhur nga popujt, të cilët flasin gjuhën arabe, në mes të shek. IX–XII, kanë qenë në një shkallë shumë të lartë, aq sa mendjet tona shtangen. Sepse popujt e Lindjes së Mesme ishin ata që e udhëhoqën botën në dy periudha:*

- *të paktën gjatë dy mijë vjetëve para kulturës greke*
- *dhe në mesjetë gjatë katër shekujve.*

Prandaj nuk ekziston pengesë për këto popuj që të udhëheqin botën edhe një herë në një të ardhme të afërt apo të largët”.

2. George Sarton (1884–1956): Ka qenë kimist dhe historian belg, i cili konsiderohet si themeluesi i disiplinës së historisë së shkencës. Largohet nga Belgjika për shkak të Luftës II botërore dhe vendoset në ShBA, ku dhe kaloi jetën e tij në kërkime dhe shkrime rreth historisë së shkencës.

Ndër ata, të cilët kanë kërkuar në këtë fushë, rreth mendimit Islam, është amerikani Lothrop Stoddard³, i cili tërheq vëmendjen dhe i komenton qëndrimet e evropianëve dhe të amerikanëve rreth forcës së “bashkimit mendor”, e cila ekziston tek myslimanët dhe lidhjet e forta, për të cilat ata janë treguar të paafte për t’i shkatërruar.

Prej mendimeve të tij rreth shkatërrimit të këtyre lidhjeve të forta është edhe: “Shembja e sistemit politik, e cila është e ngjitur fort me besimin (akiden) si mishi me kockën, pra Kalifati”.

Pastaj, autori përveç këtij mendimi përmend edhe një shkak tjetër rreth këtij “bashkimi islam” dhe ajo është shtylla e pestë e Islamit, Haxhi, i cili duke shfaqësuar rrugën e mendimit të tij thotë: *"Universalizmi islam me gjithë kuptimin e tij të plotë dhe me mendimin e tij universal është me të vërtetë një ndjenjë e bashkimit të përgjithshëm dhe nyja e fortë, për të cilat nuk ekziston ndarje te të gjithë besimtarët kudo që ndodhen në botë. Dhe zanafilla e saj është e vjetër, e cila e ka rrënjën*

3. Theodore Lothrop Stoddard (29.6.1883 - 1.5.1950) - Historian amerikan, gazetar, antropolog, eugenik dhe teoricien politik.

tek misionari i "Mesazhit Hyjnor", pra qysh në kohën kur Muhammedi filloi përpjekjet e tij për përhapjen e Mesazhit rreth të cilit u mblodhën muhaxhirët dhe ensarët të lidhur fortë për litarin e Islamit në luftë kundër idhujtarëve".

I Dërguari arriti ta kuptojë rëndësinë e universalizmit islam dhe gradën e lartë, madhësitinë, dinjitetin e vendin që zë ky universalizëm tek besimtarët. Për këtë mbolli në zemrat dhe në shpirtrat e tyre, me dorën e tij, fidanin e globalizmit islam, i cili më pas u rrit dhe lëshoi rrënjët e tij duke i forcuar ato e duke u ndërthurur trupi me degët, prej të cilit dolën frutat e para.

Me gjithë rrjedhjen e 14-shekujve dhe me gjithë sulmet që shijoi gjatë këtyre shekujve, universalizmi islam kurrë nuk u mposht e as u vjetrua, por përkundrazi lulëzoi më tepër duke iu shtuar forca dhe krenaria e tij.

Me të vërtetë uniteti sot ndërmjet myslimanëve është shumë më i fortë se te të tjerët, megjithëse nuk mohohet fakti se në disa vende islame ndodh që të grinden myslimanët mes tyre, ndoshta edhe vriten, por gjithë këto grindje dhe polemika nuk

kanë vlerë më tepër se sa një konflikt, ose mosmarrëveshje që ndodhë mes pjesëtarëve të një familjeje, pra në Islam nuk ka mëri dhe nuk ka armiqësi, ndër vështirësi zhduket inati, mëria e smira ndërmjet myslimanëve dhe pajtohen për mosmarrëveshjet e tyre duke u bashkuar të gjithë të lidhur fortë mes tyre, në një unitet të pandarë për t'i bërë ballë armikut, i cili ka sulmuar, për ta shporrur e për ta larguar rrezikun që i kanoset.

Është e vërtetë se nuk ka fe që ekziston sot në botë, e cila ka bashkuar ndjekësit e saj ashtu si Islami i ka bashkuar ithtarët e tij. Edhe pse myslimanët nuk janë të një race apo një ngjyre, kjo nuk i pengon ata aspak që ta ndjejnë veten si një trup i vetëm, me një unitet e dashuri për njëri-tjetrin duke u kapur fort me thelbin e fesë Islame.

Me gjithë shtrirjen e madhe të Islamit në popuj e vende të ndryshme, nuk ka ndodhur kurrë që një popull apo vend, i vogël qoftë apo i madh, të cilët kanë pranuar Islam, të jenë larguar prej tij.

Ka ndodhur që myslimanët janë dëbuar prej disa vendeve, të cilat ishin çliruar prej tyre e ku kishin ngritur mbretëri si,

Andaluzia etj, por dhuna e tmerrri i ushtruar mbi ta ka bërë që disa prej tyre të ndërrojnë fenë, e jo qëndrimin e tyre ndaj kësaj feje universale.

I gjithë uniteti Islam është i ngritur në dy prej shtyllave të tij e jo më shumë:

Haxhi (pelegrinazhi) për në shtëpinë e shenjtë, Qaben dhe, *Kalifati (sistemi politik islam)*.

- **Haxhi:** Zoti (xh.sh) e bëri obligim haxhin për të gjithë ata që kanë mundësi, obligim shenjtëror. Për këtë arsye, Meka vazhdon të jetë edhe sot e kësaj dite vendi i bashkimit dhe i unitetit të mbarë myslimanëve, ku çdo vit mbledhen me mijëra haxhilerë, delegatë të ardhur prej çdo trualli të kësaj bote në të cilin jetojnë myslimanët.

Dhe atje duke qëndruar përpara Qabes madhështore, myslimanët njihen mes tyre edhe pse nuk janë të një gjuhe apo race. Shkëmbejnë ndjenjat e tyre miqësore e vëllazërore, interesohen për punët dhe gjendjen e njëri-tjetrit, pastaj kthehen andej nga kanë ardhur duke mbajtur me vete një

emër të ri, me të cilin njihen si persona të devotshëm mes vëllezërve të tyre myslimanë.

Janë të njohura dobitë dhe të mirat që përfitohen nga Haxhi. Për këtë nuk ka nevojë të përmenden, por mjafton të themi se Haxhi është me të vërtetë një kongres islam që mbahet për çdo vit, në të cilin delegacionet dhe përfaqësuesit myslimanë studiojnë e përpilojnë plane të reja në interes të çdo myslimani kudo që ndodhet në botë.

- **Kalifati:** Sa për Kalifatin është i pamohueshëm fakti se, ai zë një vend të lartë e madhështor në historinë e vet, sidomos në periudhën e tij fillestare. Në kohët e fundit filloi të shuhej drita e kalifatit, e cila u shndërrua në formë imagjinare, ku sulltanët turq i kishin vënë vetes së tyre emrin kalifë, por përsëri bota islame e pranonte kalifatin e tyre.

Këta sulltanë nuk e ruajtën ashtu si duhet krenarinë e Kalifatit në botën islame, siç e kishin mbajtur paraardhësit e tyre, kalifët Rashiditë e të tjerë të mëdhenj nga kalifët abasitë në Bagdad.

Sulltan Abdul Hamidi sakrifikoi shumë dhe u përpoq së tepërmi për ringjalljen e Kalifatit dhe për t'i kthyer edhe një herë madhështinë e krenarinë e tij në botën islame. Ajo që ai arriti të fitojë, nuk ishte shkak prej shkaqeve të kalifatit në pikëpamje fetare, por për shkak të ndjenjave të përgjithshme, të cilat u shfaqën dhe u ndezën në zemrat dhe shpirtrat e myslimanëve për ringjalljen e universalizmit madhështor islam.

Një gjë është e qartë se, forca e madhe e universalizmit nuk qëndron më në "Kalifat", por në "*Qaben e Shenjtë*", ku çdo vit mbledhen delegatët myslimanë nga të gjitha anët e botës islame për të shtruar e për të vënë direktiva e plane, të cilat do të ndihmojnë në ringjalljen e *universalizmit islam*, në po atë rrugë që qenë paraardhësit e tyre.

Rreth kësaj teme po përcjellim atë që dr. Ahmed Sheuket përmend në lidhje me myslimanët: "*Me të vërtetë ky mysliman i zgjuar dhe trim ka lënë gjurmët e diturisë e të artit, të nderit e të krenarisë dhe është po ky mysliman, i cili ka fjetur një gjumë të thellë gjatë shumë viteve, tashmë ai është zgjuar dhe po thërret: "Ja ku jam, nuk kam vdekur akoma,*

unë po kthehem në jetë, jo që të jem vegël farkëtari e as një turmë njerëzish, të cilët ecin nga t'i shtyjnë erërat dhe furtunat”.

Në revistën amerikane, “Ngjarje historike” shkruhet: “Muhamedi përgatitet të kthehet” dhe titullin e pason fjalia me këtë kuptim: “Me të vërtetë myslimanët kanë qenë në gjumë për 500 vjet dhe tani po fillojnë të lëvizin drejt pushtetit”.

Për këtë flet edhe Marmaduke Pickthall⁴, por në një formë tjetër: “Myslmanët mund të përhapin qytetërimin e tyre në këtë kohë me të njëjtën shpejtësi me të cilën e kanë përhapur më përpara në qoftë se kthehen tek Kalifati i tyre, në të cilin kanë qenë në kohën kur ata luanin rolin kryesor, sepse kjo botë e zbrazët nuk mundet t'i bëjë ballë shpirtit të tyre civilizues”.

Ndërsa Dr. Laurence Brown flet haptas kur thotë: “Me të vërtetë myslimanët janë barrikada e vetme në fytyrën e kolonizatorëve evropianë”.

4 (Muhamed) Marmaduke Pickthall (7.4.1875 - 19.5.1936): Studiues islam perëndimor, i cili ka përkthyer Kur'anin në gjuhën angleze. Është konvertuar nga Krishterimi në Islam. Picktall ka qenë novelist, gazetar, udhëheqës politik dhe fetar. Ka deklaruar islamin e tij në një formë dramatike pas fjalimit të tij: “Islami dhe Progresi”, më 29 nëntor 1917 në “The Muslim Literary Society, në Notting Hill, West London.

Në gjyqin e tij, gjenerali francez Charles, i cili ishte akuzuar për moskryerje të detyrës ashtu si duhet në luftë me Algjerinë, thotë para trupit gjykues: *“Si mundeni të kërkonti nga unë të arrij atë që dëshironi prej planeve tuaja në një popull ku një njeri i vetëm prej tyre, edhe pasi të kemi shkelur mbi trupin e tij vazhdon të mbajë në zemrën e vet Mesazhin, të cilin ai e sheh si obligim të tijin ta vendosë në zemrën e ushtarit francez”?!*

Një profesor i universitetit të Sorbonit thotë: *“Në botë ekzistojnë tri fuqi; Fuqia e Perëndimit, Fuqia e Lindjes dhe një fuqi e tretë, e cila po ta njohë veten e saj, do të mundet të trashëgojë dy fuqitë e tjera. Kjo fuqi është e fshehur pas “zgjimit” të myslimanëve, sepse tek ata ekziston një vështrim për të cilin dallohen nga e gjithë bota në krijimin e strategëve, burrave të shtetit”.*

Po e mbyllim këtë vështrim mbi kërkimet dhe studimet e bëra në lidhje me Islamin me fjalën e një nëpunësi në Ministrinë e Jashtme franceze në vitin 1956 që thotë: *“Ajo që vërej unë është se, komunizmi nuk përbën aspak rrezik për Evropën, sepse si duket ai është hallkë prej hallkave që ndjekin njëra-tjetrën, ndoshta*

rreziku i vetëm prej komunizmit mund të jetë ai politiko-ushtarak, por sido që të jetë ky nuk është aspak rrezik për qytetërimin, i cili na rrezikon neve dhe ideologjitë tona. Por, ankthi jonë i vërtetë dhe i drejtpërdrejtë është rreziku islam. Myslimanët janë botë e pavarur, të cilët jetojnë në një pavarësi të plotë prej nesh, Perëndimit. Ata posedojnë një pasuri shpirtërore të veçantë dhe mburren me historinë e qytetërimit të tyre. Ata janë të denjë të hedhin themelet e një bote të re pa pasur nevojë për “oksidantalizëm”, pra pa pasur nevojë për shkrirjen e personalitetit të tyre qytetëruar e shpirtëror në formën e personalitetit civilizues perëndimor. Shansi dhe mundësia për realizimin e ëndrrave të tyre është zhvillimi industrial, të cilin Perëndimi e ka në dorën e tij dhe sapo ata të marrin njohuri në këtë fushë e të përgatisin kushtet për zhvillim e prodhim industrial në fushë të gjerë do të dalin në botë duke mbajtur me vete pasurinë e tyre civilizuese të sapolindur dhe duke mënjanuar qytetërimin perëndimor për ta vendosur atë në muzetë e historisë”.

Jemi përpjekur shumë gjatë sundimit tonë të gjatë në Algjeri të mbizotërojmë mbi personalitetin historik të këtij vendi e populli,

kemi sakrifikuar çdo gjë për të futur tek ata mentalitetin e njeriut perëndimor, por vetëm dështim i plotë ka qenë rezultati i gjithë këtij mundi të gjatë.

Sot bota islame ndodhet mbi një pasuri marramendëse të arit të zi e lëndë të tjera të para industriale, të cilat janë të domosdoshme për shkencën dhe industrinë e re. Bota Islame ka shumë nevojë për pavarësi që t'i shfrytëzojë këto pasuri të mëdha që gjenden në brendësinë e maleve, fushave dhe shkretëtirave. Ajo jeton në kulmin e historisë së kultit të parasë, e të cilat janë pranga. Pasuri gjigante që akoma nuk ka zbuluar veten e saj në atë masë që duhet. Ajo është e tronditur dhe e shqetësuar, e urren të kaluarën e saj të hidhur.

Prandaj t'i japim e t'i ofrojmë kësaj bote (islame) çdo gjë që dëshiron, të hedhim tek ata urrejtjen e prodhimit dhe t'i eksportojmë atyre prodhimet më të fundit të industrisë, me kusht që t'i largojmë ata nga fusha e artit dhe e prodhimit industrial. Në rast se tregohemi të paaftë për arritjen e këtij qëllimi dhe nëse bota islame çlirohet nga prangat e injorancës, ku ajo të shfrytëzojë

gjithë këtë pasuri gjigante, atëherë do të pranojmë dështimin e shpejtë. Dhe, rreziku i botës arabe dhe i fuqisë së madhe të Islamit do të bëhet rrezik i menjëhershëm dhe i pashmangshëm, ku qytetërimi perëndimor do të ekspozohet ndaj një katastrofe historike, e cila do ta fundosë Perëndimin dhe misionin e tij udhëheqës.

Qëllimet e njeriut të qytetërimit evropian dhe kuptimet e tij

Prej mendimeve të këtij njeriu del se drejtësia, e vërteta dhe nderi nuk janë prej të drejtave dhe lirive të njeriut prej faktit se ai është njeri, por sepse ai ka në dorë forcën, e cila ia jep të drejtën për t'ia marrë me fuqinë që zotëron, në rast se ai kundërshton t'ia kthejë. Pra, ky mentalitet që sundon te njeriu i qytetërimit evropian e bën atë të frikësohet së tepërmi, sepse ndjen se ai do ta humbasë atë të drejtë dhe liri, në rast se dikush tjetër do të posedojë atë që ai posedon, ose më shumë. Dhe, kur ta kërkojë këtë gjë, atëherë

do të sundojë mbi veten e tij. Është shumë i qartë shembulli për këtë gjë. Ideja e tokës së djegur në Algjeri është një gjurmë natyrore për këto ndjenja te francezët.

Njeriu i qytetërimit evropian nuk e ka harruar historinë e tij. Ai e di shumë mirë se si është sjellë me njerëzimin tre shekuj me rradhë, sikur ai të ishte një egërsirë. Kur e kuptoi e ndjeu peshën e krimit të tij, atëherë ndodhi që u trondit dhe filloi të shqetësohej për veten e tij. E mbuluan ethet për ato krime e vepra mizore që kishte bërë, vepra prej të cilave akoma tmerrohet nga frika se mos ngrihet mbi të gjykimi, mbasi është duke e parë se çdo gjë ka filluar t'i dalë nga dora dhe është drejtuar për në dorën e dikujt tjetër. Është i sigurt për atë që ndjen se, ajo do të ndodhë me të vërtetë në të nesërmen. Ai është pikërisht si keqbërësi, i cili ndjen ndërgjegjen e krimit të tij që ka filluar ta shtrëngojë, ditë pas dite dhe fillon të mendojë sikur ai ka dalë përpara drejtësisë.

Ky njeri nuk është i drejtë, sepse ai ka dalë nga një qytetërim jo i drejtë dhe nuk mund ta përfytyrojë këtë jetë ndryshe, veçse si njeri shtypës e tiran, ose njeri i dobët e i

pafuqishëm, sepse filozofia e civilizimit të tij është e tillë. Kështu ai e kuptoi luftën për ekzistencë dhe kështu jetoi e vazhdon të jetojë.

Bota sot ka nevojë për një qytetërim, i cili nxjerr një njeri që kur është duke ecur mes njerëzve ndjen se ai është i sigurt, jo sepse mban armë e dikush tjetër nuk e mban atë, por se tek ai ekziston një mendim tjetër për armën dhe njeriun, krejt ndryshe me mendimin e njeriut të civilizimit, i cili tashmë ka filluar të japë shenjat e para të perëndimit të tij.

Njeriu i ri që do të dalë nga ky qytetërim mundet që të jetë shumë i zellshëm për armë, jo që ai të jetojë si shtypës apo tiran, por që të ndalojë shtypjen e padrejtësinë dhe të përhapë paqen e sigurinë.

Kam mendimin se ndoshta do të habitesh dhe do të qeshësh shumë sikur të shikosh një njeri, të cilit i ndryshon ngjyra e fytyrës në rast se shikon “ruajtës rendi”, i cili mban me vete armë, pastaj fillon t’iu flasë për tmerrin që mund të shkaktojë ky “ruajtës rendi” me ndonjë shkatërrim që mund të bëjë .

Ky njeri, të cilit i ndryshon ngjyra e fytyrës mundet që mendja e tij të jetë elektronike, të ardhurat financiare t'i ketë shumë të mëdha, ose mund të jetë kozmonaut i ndonjë anije kozmike, por koncepti i civilizimit të tij është i natyrshëm me të. Me gjithë këtë, ai ose është i fortë e shtypës, ose i dobët e i shtypur. Atë e ka mbizotëruar ky koncept qytetërimi, ka lëshuar rrënjë në të dhe as që mundet ta konceptojë ndryshe, koncept i cili është ngulitur e skalitur që shekuj më parë.

Sikur ndonjë djalosh këmbëzbathur me rroba të vjetruara nga një vend të vijë te njeriu që i ndërron ngjyra e fytyrës, ose te kozmonauti i anijes kozmike, i cili është nën protektoratin e kolonizatorëve në jug të Arabisë dhe i thotë atij: "Mos ki frikë nga "ruajtësi i rendit", i cili mban me vete "bombë shpirtërore" edhe pse shpërthimi i saj është shumë më i dëmshëm se një bombë me eksploziv". Ose, ai mund të jetë hipur mbi "burak" për të përshkuar shtatë qiejt, sepse shoqëria në të cilën jeton ky "ruajtës rendi" koncepton anën e tretë të jetës së njeriut, ku nuk ka arritur akoma mendja elektronike.

Kjo anë e tretë thotë se njeriu në këtë qytetërim nuk është i sigurt për arsyen se ai është i armatosur shumë, por është i sigurt sepse ai nuk është shtypës. Prej këtu fillon të shndërrohet ngjyra e fytyrës në zemërim anësor dhe thotë: Ky njeri i dobët e me rroba të vjetra është më i rrezikshëm se komunizmi, sepse komunizmi nuk ka dalë jashtë koncepteve të tij, por këta këmbëzbathur e të leckosur janë plotësisht në gjendje ta shndërrojnë qytetërimin tonë në muze historie dhe të na shporrin neve nga vendi i udhëheqjes e të fshijnë filozofinë tonë nga ekzistenca.

Këto koncepte të rrezikshme, të cilat i mban ky varfanjak janë shumë të thella në brendësinë e njeriut, edhe më të thella se kërkesat e punëtorëve apo mbrojtësit e kapitalizmit. Prandaj t'i prodhojmë atyre makina e frigoriferë, të xhirojmë filma e çdo gjë që shkon në mendje, prej mjeteve të dëfrimit e të kënaqësisë në mënyrë që ata të mos shpikin e prodhojnë asgjë. Përndryshe gjendja jonë do të jetë ashtu si ka thënë Mr. Gladstone⁵ në fund të shekullit 19-të në

5 William Ewart Gladstone (29.12 - 19.5.1898) ka qenë një burrë

Parlamentin Anglez: *“Sa kohë që ky Kur’an të ekzistojë te myslimanët, kurrë Evropa nuk do të mund të sundojë mbi Lindjen dhe as që mund të jetë e sigurt”*.

Por sa për ne, nuk mendoj se ka vlerë ta përsërisim atë që: *“Është prej traditave e parimeve tona të themi në këto lloj rastesh: “Shkoni dhe jeni të lirë”*.”

Tani, ajo që kërkohet nga ne është që të ecim në drejtim të arritjes së kësaj dite, në të cilën kemi plotësisht të drejtë të nxjerrim një ligj të tillë faljeje. Dhe, atëherë kemi mundur të zgjidhim nyjën e kozmonautit me lëkurë të bardhë, ku më pas është i barabartë dhe i largohet tronditja e shqetësimi që e kishte munduar gjithmonë. Tani ndjen një qetësi të thellë dhe lumturi të plotë të cilën as që e ka ëndërruar edhe në ditët e sundimit të tij, sepse frika nuk e ka lënë kurrë vetëm.

shteti anglez liberal, i cili ka shërbyer 4 herë si kryeministër i Britanisë (1868-1874, 1880-1885, shkurt-korrik 1886 dhe 1892-1894). Ai ka thënë se: “So long as there is this book, there will be no peace in the world” (Sa kohë ky libër të ekzistojë, në botë nuk do të ketë paqe).

Dr. Muhamed Said Ramadan El-Buti

3 | **ISLAMI MES RINOVIMIT TË
KËRKUAR DHE NDRYSHIMIT
TË REFUZUAR**

(“Zoti dërgon në këtë ymmet, në krye të
çdo 100 viteve, dikë që rinovon fenë”)

(hadith profetik)



Falënderimi i takon Allahut që me mirësinë e Tij plotësohen të mirat, paqja dhe shpëtimi qofshin mbi zotërinë tonë Muhammedin (a.s), familjen dhe mbi gjithë shokët e tij.

Transmeton Ebu Davud, Bejhakiu dhe Hakimi në “Mustedrekun” e tij nga hadithi

i Ebu Hurejres se Pejgamberi (a.s) ka thënë:
*"Zoti dërgon në këtë ymmet, në krye të çdo
 100 viteve, dikë që rinovon fenë".*

Transmeton Imam Maliku në librin e tij
 "El-Muvet'ta" dhe Muslimi në "Sahihun" e
 tij, nga Ebu Hurejra, se Pejgamberi (salall-
 llahu alejhi ve sel'lem) përshëndeti me
 selam banorët e Bakias, pastaj tha: *"Sa do
 të dëshiroja të shikoja vëllezërit tanë, deri
 që tha: "Vall-llabi do të largohen nga Houdi
 im disa njerëz, ashtu siç largohet deveja e
 humbur dhe them: Ejani, hë pra ejani! Më
 thubet: Ti nuk e di se sa kanë bërë ndryshime
 pas teje. Atëherë them: Larg qofshin, larg
 qofshin, larg qofshin..."*

D.m.th. rinovimi i fesë është i përligjur
 dhe i obliguar, madje kjo është një prej
 vlerave me të cilat Zoti (azze ve xhel-le)
 pajis me të dijetarët e devotshëm, pasi kanë
 përfunduar të gjitha mesazhet hyjnore me
 dërgimin e të fundit të resulëve dhe enbijave,
 Muhammedit alejhi es-selatu ves-selamu...
 ndërsa ndryshimi është humbje e amanetit,
 tradhti e besës dhe shpifje ndaj Zotit azze
 ve xhel-le. Për këtë ai (ndryshimi) është i
 ndaluar dhe bëhet shkaktar për t'u larguar

nga mëshira e Zotit.

Por cili është dallimi në mes këtyre të dyjave?.. Cili është dallimi mes rinovimit të fesë dhe ndryshimit të saj?

Kuptimi i rinovimit del qartë në qoftë se do të ndalonim pak te prejardhja dhe kuptimi i fjalës “*din*” (fé). Dihet mirë se fjala “*din*” (fé) rrjedh nga “*dejnune*” (fetarizëm), d.m.th nënshtrim i plotë për të Adhuruarin e Vërtetë, Allahun (azze ve xhel'le). Ne këtu kemi parasysh me fjalën “*din*” (fé), fenë e vërtetë e cila është Islami. Kështu që “*din*” dhe “*dejnune*” janë cilësi për njeriun, dhe rinovimi është epror mbi të d.m.th mbi vetë fenë, jo mbi parimet dhe ligjet e saj. Ai simbolizon punën e atij që Zoti dërgon për rinovimin e fesë, pra në nxitjen e njerëzve për të rinovuar besën e tyre me Zotin dhe në kthimin e duhur, në udhëzimin dhe dispozitat e Tij, pas një largimi të gjatë... Në rimëkëmbjen dhe fortifikimin e shtyllave të dobësuara, në mbylljen e vrimave të hapura, në mentalitetet dhe nxjerrjen e ligjeve te reja nga ngjarjet, interesat dhe traditat. Gjithnjë duke u bazuar në gjeneralitetin e ligjeve juridike islame, mbi parimet themelore të

fesë dhe rregullat e komentimeve të teksteve kuranore, pa neglizhuar aspak me to dhe pa rënë në kurthet e dëshirave, epsheve dhe interesave momentale të kësaj bote.

Kjo gjë bën të qartë shkakun e mbizotërimit të rinovimit në tekstin e hadithit, për fenë (dinin), që është fetarizmi (dejnune), siç e pamë, dhe jo mbi thelbin e fesë që përfshin parimet dhe ligjet e saj, siç e transmetojnë disa njerëz. Ky është gabim në secilën prej kuptimeve dhe transmetimeve së bashku... Gabim në transmetim, sepse të gjitha këto transmetime kanë ardhur me fjalët: *“Dikënd që rinovon fenë për këtë ummet”* dhe ky është gabim në transmetim, sepse rinovimi i çështjes së fesë nuk ka të bëjë me rinovimin e ligjeve dhe parimeve të saj. Ajo mbetet e re pa marrë parasysh se sa kohë ka kaluar, pra nuk ka kuptim rinovimi i tyre përveçse me ndryshimin të cilin e ëndërrojnë propaganduesit e *“të resë”*, për të cilin (ndryshim) ka ndaluar dhe tërhequr vëmendjen i Dërguari i Zotit (salall'illahu alejhi ve sel'lem).

Por, duhet ta dimë mirë se ky rinovim, që Zoti ia ka besuar një grupi të përkushtuar

prej dijetarëve të këtij ummeti, nuk mund të jetë i saktë në një rrugë të drejtë që kënaq Zotin (azze ve xhel'le) dhe as vërtetim i rinovimit që Pejgamberi (a.s) ka pasur për qëllim, vetëm atëherë, kur luftëtarët e këtij rinovimi të jenë në një shkallë përkushtimi të lartë në nxitjet dhe nismat e tyre. Prej atyre që nuk i kushtojnë aspak rëndësi dynjasë së njerëzve para qëllimit të shenjtë, i cili simbolizohet vetëm me arritjen e kënaqësisë së Zotit. Nuk pengohen nga epshet e dëshirat në rrugëtimin e tyre drejt Tij, sado që këto të jenë të shumta, vërshuese e të përhapura këtu e atje... Ngrihen për realizimin e detyrës së tyre të shenjtë, me gjuhën e gjendjes së secilit prej tyre, duke thirrur Zotin: **“Dhe nxitova drejt Teje, o Zot, që të kënaqesh”**. (*Sureja TaHa: 84*)

Në qoftë se Zoti do ta nderojë këtë ummet me një grup të tillë dijetarësh, atëherë do të jetë rinovimi i fesë, kështjella e cila do ta mbrojë atë nga lakmitë për ta dëmtuar dhe nga talljet me të. Do të jenë vetë ata, ajo që ka pasë për qëllim dëshmia e të Dërguarit të Zotit (a.s) e, sa e madhe është ajo dëshmi!

Ne dimë mirë atë që kanë përmendur komentuesit e hadithit për fjalën (*men*) “*dikë*” në thënien e tij (a.s) “*dikë që rinovon fenë për këtë ummet*”. Kjo dëshmi nuk simbolizon një person të vetëm në të cilin janë mbledhur cilësitë e udhëheqjes dhe të rinovimit, (siç kanë menduar disa), por ajo nënkupton të gjithë dijetarët, të cilët Zoti (xh.sh) i zgjedh në çdo kohë, për të mbrojtur fenë e Tij, për të rinovuar kthimin tek Ai dhe sinqeritetin për Të.

Ky është shkurtimisht *Rinovimi*, i cili është pjesë e detyrave të fesë dhe ligjeve të saj.

Tani kemi mundësi ta dimë se pas asaj që përmendin shumë studiues dhe shkrimtarë në këtë kohë si “*rinovim*”, në realitet nuk është gjë tjetër veçse ndryshimi për të cilin ka paralajmëruar i Dërguari i Zotit dhe e ka bërë të qartë në hadithin e saktë që përmenda në fillim të këtij shkrimi.

Pjesa më e madhe e propagandave të shqetësuara sot, në botën arabe dhe islame, janë për ndërrimin e fesë dhe jo për rinovimin e saj. Këto propaganda mbulohen me fjalët rinovim apo të ngjashme me të...

Shtytësi kryesor i kësaj është një përzierje e faktorëve të ndryshëm, si: mërzitja nga “*e vjetra*”, sepse ajo është “*e vjetër*”. Dëshira për t’u shmangur nga disiplina fetare e ligjeve të saj, duke u munduar të realizojnë atë që ëndërrojnë njerëzit prej epsheve e dëshirave dhe, të vardallisen në llucën e asaj që rrjedh në shoqëritë amullore të perëndimit... Gjithashtu, gatishmëria për të qenë vartës të lidhjeve të fshehta të cilat kanë depërtuar nga jashtë prej vendeve që zhvillojnë luftë ideologjike drejt vendeve ku ndodhen agjentët e tyre të brendshëm. Kush prej jush ka pasur mundësi të lexojë dosjen e fshehtë të shkruar nga Mr. William Clifford, që e ka dërguar në departamentet e Perëndimit, sidomos ato amerikane, përgjegjëse mbi vëzhgimet e gjendjes së fesë Islame në këto vende, do të mësojë shumë gjëra prej të cilave po përmendi në këtë nxitim.

Ndërsa faktori kryesor, prej të cilit rrjedhin të gjithë faktorët që përmenda, është faktori ideologjiko-besimor, i cili do të thotë se propaganduesit e kësaj thirrje e konceptojnë Islamin sikur ai është një bashkësi organizatash (sistemesh) sipërore

që janë krijuar nga mendja arabe në një kohë të errët. Pastaj duke kaluar koha ato konsumuan të gjitha arsyet e ekzistencës së tyre të asaj periudhe (kohe).

Një dialog serioz me këta tipa, duke ditur se gjendja është kjo që thamë, nuk nënkupton që t'i bind ata se Islami, (që në mendjet e tyre ka këtë imazh dhe realitet), është i vlefshëm për çdo kohë. Sepse është e pamundur të bindësh dikë se një sistem, të cilin e ka shpikur një mendje njerëzore si ai, vlen të jetë rrobë e saktë dhe e përshtatshme për një varg të pafund brezash njerëzor, pa asnjë ndryshim apo deformim.

Por, dialogu i vërtetë qëndron në mundësinë për t'i treguar atyre se Islami me parimet e besimit dhe rregullat e tij morale është mesazhi, me të cilin Zoti ka nderuar krijesat e Tij në jetën e kësaj bote. Ai e zgjodhi atë (Islamin) për ta, udhërrëfyes për njohjen e të vërtetave të gjithësisë, metodë (program) bashkëpunimi për jetën. Për t'u bërë e qartë se vendimi, të cilin e kemi marrë nga Kur'ani thotë: **“Sot përsosa për ju fenë tuaj, plotësova ndaj jush dhuntinë Time,**

zgjodha për ju Islamin fe”⁶, nuk është fjalë e ndonjë njeriu, por thirrje e Allahut e shpallur për krijesat e Tij.

Në qoftë se do të arrijnë ta kuptojnë këtë gjë dhe do të ngulitet akideja e besimit realisht në mendjet e tyre, atëherë problematika e “*ndërrimit*” me emrin e “*rinovimit*” me gjithçka që rrjedh si rezultat i mashtrimit dhe çfarë nxirret nga qëllimet në të kundërtën e kuptimeve sipërfaqësore të motove e shprehjeve, treten e zhduken. Kështu, do të takohemi të gjithë së bashku në një metodë të vetme, ku e jashtëmja dhe e brendshëmja janë njëlloj.

Por, në qoftë se ky kuptim do të humbasë nga ata, në frymën e dëshirave, epsheve dhe nacionalizmave, atëherë do të mbesin sakrificat e tyre të hapura e të vazhdueshme në tretjen e të vërtetave të Islamit dhe në ekzekutimin e ligjeve (dispozitave) të tij, që rryma e tij vepruese të shndërrohet në vese e humbje!... Kjo është ajo, që ka qenë dhe mbetet duke ëndërruar Mr. William Clifford në dosjen e tij që përmenda dhe që mbështetet tek agjentët e tij të besueshëm e

6(El-Maide: 3)

nga efektivi i tij i afërt, të cilët lëvizin mes nesh sipas planeve të tyre nën mbulesën e xhelozisë së rinovimit të Islamit dhe përparimit të tij!..

Por, edhe nëse ky kuptim do të humbasë në labirintet e këtyre dëshirave (epshe), a do të ndikojë në shkëputjen e rrugëve të dialogut në mes nesh?

Rrugët e dialogut do të mbesin të shtrira, mes nesh dhe të tjerëve, kushdo qofshin ata. Kjo është klima islame, brenda së cilës veprojnë thirrësit e përkushtuar, në çdo kohë dhe vend...

Ne u themi atyre: Islami ynë të cilin e njohëm si shpallje e zbritur, është nga i Gjithëfuqishmi i qiejve dhe i tokës, ndërsa ai që ju iluziononi është grumbull temash e sistemesh njerëzore. Brezi i parë i myslimanëve na ka lajmëruar me parimet dhe rregullat e tij për një kushtetutë e cila ka qenë dhe është energjike, nuk devijon dhe nuk e pason asnjë prapambetje.. Kjo kushtetutë shkurtimisht përmbledhet në atë që prej madhësisë së Islamit është të nxisë përparim e zhvillim pa ndryshuar ai vetë... D.m.th, aq sa të jenë myslimanë të besës me

parimet e Islamit dhe dispozitat e tij, nuk neglizhojnë me to dhe nuk i ndryshojnë! Sepse ai i shtyn ata për në majat e zhvillimit e të përparimit, pa ndaluar. Dhe po aq sa të abuzojnë me dispozitat dhe rregullat e tij, do të shfaqen në mes tyre faktorët e prapambetjes e të mos-zhvillimit.

Në këtë këndvështrim, Islami i ngjan makinës, me të cilën dëshiron të shkosh në një vend. Sa më i vëmendshëm, i kujdesshëm dhe i ruajtur të jesh me të, me pjesët dhe me përdorimin e saj, ti do të udhëtosh me shpejtësinë që dëshiron... Në qoftë se ti do të luash me të, do të ndryshosh mekanizmin dhe mënyrën e punës së saj, duke shpresuar që ta përparosh dhe të braktisësh mënyrën e punës së saj të zakonshme, atëherë ajo, (në të kundërtën e asaj që ti mendon), patjetër do të zhgënjejë duke të lënë në vend dhe si rrjedhojë ti nuk do të shkosh e as do të udhëtosh për në vendin që dëshiron.

A e vure re makinën dhe kushtin e saj të domosdoshëm, në mënyrë që të çojë në vendin që dëshiron? Kështu është edhe Islami! Ai është anija që të mbart ty me urdhrin e Allahut, nga një nivel në një tjetër

më të mirë, një njeri të vetëm apo shumë njerëz! Por me kushtin e vetëm: Islami të qëndrojë në atë formë që Ai (xh.sh) e ka zbritur. Ndërsa kush refuzon dhe mundohet të hyjë në sheriatin dhe urdhrat e Allahut, në atë që Ai ka përsosur dhe zbritur, ai do ta prishë anijen dhe si rrjedhojë do t'i marrë jetën vetes së tij, duke e ditur ose duke mos e ditur, duke ngelur në vend dhe duke mbetur prapa.

Argument për këtë që them janë faktet që dihen, se myslimanët përparuan në pesë shekujt e tyre të parë (periudhë kur sundonte dhe vepronte Islami) më shumë se sa myslimanët e kohëve të fundit deri në ditët e sotme. Kjo gjë ka ndodhur duke mos pasur asnjë ndjenjë për të evoluar gjë prej ligjeve të Islamit dhe sheriatit të tij, madje për t'ia arritur atij përparimi të shkëlqyer, garanti i tyre ka qenë ruajtja me rigorozitet e ligjeve të Islamit dhe sheriatit të tij, pa neglizhuar e abuzuar aspak me këto ligje.

Po ju sjell një panoramë të këtij përparimi të shkëlqyer dhe të shpejtë, i cili ka vendosur standarde në jetën e brezave dhe kjo prej mirësisë së anijes së Islamit, që përparoi pa

u modernizuar.

- Në fushën e ndërtimit, të dukurive shoqërore dhe të veprimtarive ekonomike u shfaqën standarde (shembuj) të shumtë të cilët nuk kishin ekzistuar më parë në jetën e sahabëve të Pejgamberit (a.s). Prej këtyre standardeve (shembujve) po përmendim sa vijon:
- Myslimanët filluan të përdorin për materiale ndërtimi tulla, gurë, gëlqere, ndërsa më parë ndërtesat bëheshin prej kallamash dhe degë hurmi.
- Mëkëmbësit filluan të ndërtonin kështjella të fortifikuara për të kryer funksionet dhe detyrat e tyre të sundimit e të drejtimit dhe të shikonin me vëmendje interesat e myslimanëve.
- Inxhinierët projektonin qytetet e reja që do të ndërtoheshin. Për këtë kemi shembull qytetin e Kufes dhe Basrës, si dy shembujt më të dukshëm, duke

ditur që në jetën e tyre të mëparshme nuk kishte ekzistuar inxhinieria dhe inxhinierët⁷.

- U zhvillua aktiviteti tregtar, pasi më parë tregtia kishte qenë e përçmuar tek arabët, sepse atë e kryenin të huajt⁸.
- U shfaq industria (zejtaria) me llojet e saj të ndryshme që filloi të përhapet nga koha e sahabëve dhe tek të tjerët që i pasuan. Më parë ajo ishte një punë e braktisur prej arabëve.
- Myslimanët arabë, (gjatë udhëheqjes së kalifit Othman (r.a)), filluan përdorimin e mullinjve me erë duke shfrytëzuar energjinë e erës⁹.
- Ushtruan profesionin e përpunimit të lëkurës, madje u shquan në këtë fushë duke dalë edhe përmbi persianët dhe romakët.
- Ndër ta u përhapën artet figurative me të gjitha llojet e tyre dhe piktura për sendet që nuk kanë shpirt.

7. Të shihet: "El Bidaje ve en-Nihaje", të Ibn Kethirit, 7/75.

8. Të shihet: "El Med'hal, i Ibnul Haxhit", 4/105.

9. Të shihet: "Et-Teratib el Idarijetu", i Abdul Haj el Kettanit.

- U zhvillua industria e prodhimit të ushqimeve dhe metodat e sigurimit të tyre. Kështu u fut në përdorim mielli i bardhë të cilin fillimisht e importonin, pastaj arritën ta prodhonin vetë.
- Në fushën e njohurive dhe asaj të shkencës u shfaqën botimet dhe u zgjerua gama e tyre sipas nevojave të ndryshme.
- Myslimanët ishin në pararojë përta i përket marrjes së njohurive prej të tjerëve. Ata u sollën nga botimet në gjuhë të huaj, të cilat i përkthyen në arabisht. Më pas, u morën me studimin dhe përmbajtjen e tyre shkencore, kulturore dhe filozofike.

Të gjitha këto zhvillime dhe përparime të shkëlqyera u arritën në harkun e më pak se një shekulli të vetëm nga fillimi i shpalljes. Islami u bë shtysë e pasuesve të tij drejt gjithë këtyre përparimeve të shpejta në shkallën e zhvillimit, pa transformuar gjë prej parimeve dhe ligjeve të tij.

Ne e dimë të gjithë se shoqëria jonë islame, në shekujt e fundit nuk ka përparuar

qoftë edhe me 1/10 e përparimit të myslimanëve në atë shekull të parë të moshës së shtetit të brishtë islam!... Këta myslimanë ishin shembulli më i mirë i respektimit dhe i lidhjes së fortë me parimet dhe ligjet e Islamit, pa i prekur dhe pa i ndryshuar ato. Ndërsa myslimanët e kohëve të fundit, janë shembulli i abuzimit dhe i ndryshimit të këtyre ligjeve dhe parimeve, madje dhe pakënaqësisë ndaj tyre.

Habitem me ata që i ka mbuluar përtacia, rënia dhe ngurtësia, që pastaj pranuan shpikjet e tyre ndaj të vërtetave dhe realiteteve të qarta duke thënë: "Kjo është prej fajit të Islamit, i cili i ka ndaluar të përparojnë dhe i ka penguar të arrijnë zhvillimin e të tjerëve"!...

* * *

Një të vërtetë të rëndësishme, të cilën nuk duhet ta largojmë nga mendjet tona, as ne dhe as ata, të cilët i janë shmangur Islamit nën mbulesën e propagandës për modernizim dhe përparim, është se të gjithë

popujt dhe shoqëritë e tjera joarabe, kanë derdhur djersë dhe kanë shpenzuar energji në rrugën e arritjes së qëllimit të tyre për civilizim, fuqi dhe shkencë, me të gjitha mjetet e tyre materiale dhe shkencore.

Kështu që praktika e Allahut që funksionon për robërit e Tij, është e vërtetë ndaj këtyre njerëzve, se çdo kush që punon për t'ia arritur synimeve dhe qëllimeve, patjetër do të korrë frytet e punës së tij, njeri i vetëm qoftë apo shoqëri, pa marrë parasysh besimin a mosbesimin e tij. A nuk ka thënë Allahu (xh.sh) në Kur'an: **“Ne të gjithëve, atyre dhe këtyre, i japim nga të mirat e Zotit tënd. Dhe dhuntia e Zotit tënd nuk është e kufizuar”**. (*Isra: 20*)

Kështu, secilit që i rrjedhin jargët e dëshirës së modernizimit, fuqisë, shkencës dhe pasurisë të shoqërive perëndimore, u themi se ato janë fryt i djersës së derdhur dhe energjive të shpenzuara. Kështu që ishte e drejtë të korrnin frytet e mundit të tyre...

Ndërsa arabët, të cilët akoma nuk ishin bërë popull arab, mbetën të fjetur në shtratin e injorancës, varfërisë dhe përçarjes dhe të kënaqur me gjithë këtë gjendje. Ata nuk

shpenzuan energji për t'ia arritur asaj që shoqëritë e tjera perëndimore ia arritën.

Kur dielli i Islamit lindi, (lidhja dhe kapja e tyre me fenë e Allahun ishte e sinqertë), Islami u dha hov të madh, sa që për njëzet vjet arritën majën e botës pas një injorance të thellë. Arritën fuqinë pas dobësisë dhe pasurinë pas varfërisë! Çmimi i gjithë kësaj në jetën e arabëve ishte Islami! Ndërsa çmimi në jetën e shoqërive të tjera ishte mundi dhe praktika e zbatuar.

Në qoftë se ummeti arab largohet sot prej Islamit duke e braktisur atë me pretendimin e thirrjes për modernizim dhe zhvillim, atëherë praktika e Zotit do të funksionojë pa bërë lëshim, duke u kthyer ky ummet në gjendjen e tij të mëparshme, para se Islami t'i shpëtonte prej prapambetjes dhe t'i lartësonte në majën e qytetërimit dhe përparimit... Në qoftë se ata kanë pasur një të shkuar të ndritur, si rezultat i mundit dhe i energjive të shpenzuara, le ta kërkojnë dhe të kthehen në trashëgiminë e tyre, e cila është duke i pritur.

Kjo është linja e qartë në të cilën ka rënë realiteti i sotëm i këtij ummeti, i sinkronizuar

me linjën e qartë që na jep devijimi dhe sprapsimi prej bindjes dhe sinqeritetit të mëparshëm me Islamin, akiden, sheriatin dhe moralin.

Ah, sikur ky realitet, që po shqetëson ummetin arab, të na zgjojë drejt këtij ligji hyjnor, të cilin e kuptoi Umer ibn Hattabi dhe punoi me të nëpërmjet mirësisë së madhe që gjendet në të, duke thënë: ***“Ne jemi një popull që Allahu na ka bërë krenar me Islam, por sa herë që të kërkojmë krenarinë me diçka tjetër, përveç asaj që Allahu na ka bërë krenar, Allahu do të na poshtërojë”***.

Pastaj erdhëm ne dhe punuam nëpërmjet pasojave që gjinden në të. Ah sikur ne, ndërkohë që nuk morëm mësim, këshillë dhe nuk u udhëzuam prej asaj që tha Umeri (r.a), të kishim mësuar prej asaj të vërtete që ka pohuar Ibn Halduni, madje të atij realiteti shoqëror! Ai, në librin e tij, *“Mukaddime”* ka shkruar një kapitull me temë se: *“Punët e arabëve nuk kanë mbarësi, përveçse nëpërmjet fesë”*.

Gjithë esenca e kësaj që thamë është se udhëtimi i ummetit arab drejt përparimit dhe krenarisë bëhet nëpërmjet anijes së

Islamit dhe veprimtarisë së tij, pa përdorur mjet apo veprimtari tjetër. Rinovimi i tij do të thotë: *Rinovimi i marrëdhënieve me të, i singëritetit, mbështetjes tek ai dhe lidhjeve të forta pas çdo të reje që sjell koha dhe shkenca, të cilat përfshihen brenda ligjeve dhe rregullave të Islamit.*

Ndërsa puna për evoluimin dhe modernizimin e tij, (përfundimi i saj i vetëm që nuk ka aspak dyshim), do të thotë *dëmtim i kësaj anije...* Ky është qëllimi i vërtetë, i cili fshihet te propaganduesit e evoluimit dhe modernizimit dhe, kjo është ajo të cilën e quajnë "*leximi modern*".

Le ta dimë shumë mirë se ne nuk kemi anije tjetër, e cila do të na mbartë drejt aspiratave tona për përparim, unitet dhe rikthim i të drejtave, përveç anijes së Islamit!

Kjo është alternativa jonë e vetme dhe kjo është historia jonë e udhëtimit nga gremina e injorancës për në tokën e djeshme të përparimit. Ky është ligji hyjnor, i cili sundon robërit e Tij në çdo kohë dhe në çdo vend.



المصليحة الإسلامية الألبانية

دار الإفتاء - مدينة شقودرا

KOMITETI MYSLIMAN I SHQIPËRIE
MYFTINIA SHKODËR

"Nuk ka dyshim se Islami i vërtetë, s'është ai rreziku për Perëndimin, ose për qytetërimin perëndimor sot, por përkundrazi ai është "antibiotiku", i cili mbron qytetërimin perëndimor nga shkatërrimi dhe e shëron atë nga sëmundjet parazitare të përhapura sot dhe e rikthen atë në fillimin e fuqisë e të rinisë së saj, n.q.s Perëndimit do t'i jepej mundësia të mbështetej në të, ose ta kuptojë atë me të vërtetë".

Dr. Muhamed Said R. El-Buti

ISBN 978-99943-50-74-2



9

789894

350742